



|   |      |                                    |            |
|---|------|------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA           |      |                                    |            |
| QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA               |      |                                    |            |
| MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH |      |                                    |            |
| Njësia Org.<br>Org.Jedinica<br>Org Unit                           | 01   | Nr.Prot:<br>Broj Prot:<br>Prot.No: | 05-9817    |
| Nr.I faqeve<br>Br.stranica<br>No.pages                            | -18- | Data:<br>Datum:<br>Date:           | 16/12/2024 |
| Prishtinë / a   |      |                                    |            |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva*

## PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE


EMRI I PSO: MENAXHIMI I RREZIKUT NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

PËRMBAJTJA: PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE PËR MENAXHIM TË RREZIKUT NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

VERSIONI: 1.0  
DATA E APROVIMIT: 12.12/2024  
AUTOR: GP  
NR. I HAPAVE: XXIV  
NR. I NËNHAPAVE: 121

APROVUAR:

Dr. Arben Vitia  
Ministër i Shëndetësisë



|                     |   |
|---------------------|---|
| QËLLIMI             | QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE TË OPERIMIT ËSHTË QË TË OFROHEN UDHËZUES DHE PROCEDURA PËR IDENTIFIKIM, VLERËSIM, ZBUTJE (MITIGIM) DHE MONITORIM TË RREZIQEVE PËR MINISTRINË, NË MËNYRË QË TË SIGUROHET QËNDRUESHMËRIA E OPERACIONEVE KRITIKE DHE OFRIM TË SHËRBIMEVE NË VAZHDIMËSI DHE ME KUALITET NË MINISTRI. APLIKIMI I KËSAJ PROCEDURE MBËSHTETË MINISTRINË QË MË SAKTË TË KUPTOJ RREZIQET SI PJESË KRITIKE GJATË AKTIVITETEVE TË RREGULLTA DHE T'I MENAXHOJ ATO RREZIQE NË MËNYRËN E DUHUR.  |
| NDËRLIDHJA ME AKTET | <ul style="list-style-type: none"> <li>• LIGJI PËR KBFP-NË;</li> <li>• RREGULLORJA MF-NR. 1/2019 PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, QË VENDOS KORNIZËN DHE RREGULLAT THEMELORE TË MFK - SË NË TË GJITHA SUBJEKTET E SEKTORIT PUBLIK;</li> <li>• RREGULLORET E THESARIT DHE BUXHETIT;</li> <li>• LIBRI I PROCESEVE PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE NGA MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE;</li> <li>• METODOLOGJIA PËR RAPORTIM;</li> <li>• DORACAKU I PROCEDURAVE TË MFK - SË;</li> <li>• LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE TE PËRGJEGJËSIVE;</li> <li>• LIGJI PËR FINANCAT E PUSHTETIT LOKAL;</li> <li>• LIGJI PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM;</li> <li>• LIGJI I PROKURIMIT</li> </ul>   |
| SHKURTESAT          | <ul style="list-style-type: none"> <li>• ZKA ZYRTAR KRYESOR ADMINISTRATIV</li> <li>• ZKF ZYRTARI KRYESOR FINANCIAR</li> </ul>   |
| DEFINICIONET        | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>KONTROLLI I BRENDSHËM</b> - NËNKUPTON PROCESIN QË KRYHET NGA MENAXHMENTI DHE PERSONELI I SUBJEKTIT, I PËRCAKTUAR PËR ADRESIMIN E RREZIQEVE DHE OFRIMIN E SIGURISË SË ARSYESHME LIDHUR ME ARRITJEN E REZULTATEVE NË REALIZIMIN E INTERESIT PUBLIK DHE OBJEKTIVAVE TË SUBJEKTIT.</li> <li>• <b>MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI</b> - NËNKUPTON SISTEMIN E POLITIKAVE, PROCEDURAVE DHE AKTIVITETEVE TË CILAT THEMELOHEN, MBAHEN DHE PËRDITËSOHEN NË MËNYRË TË RREGULLT NGA UDHËHEQËSI I SUBJEKTIT TË SEKTORIT PUBLIK, DHE ZBATOHEN NGA PERSONELI, ME SYNIM TË ADRESIMIT TË RREZIQEVE DHE OFRIMIT TË SIGURISË SË ARSYESHME, PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË SUBJEKTIT TË SEKTORIT PUBLIK;</li> <li>• <b>AUDITIMI I BRENDSHËM</b> - NËNKUPTON AKTIVITETIN KËSHILLËDHËNËS TË PAVARUR DHE OBJEKTIV NË OFRIMIN E SIGURISË SË ARSYESHME, QË SYNON SHTIMIN E VLERËS DHE PËRMIRËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SUBJEKTIT TË SEKTORIT PUBLIK, E QË NDIHMION SUBJEKTIN NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE, DUKE OFRUAR QASJE SISTEMATIKE, TË DISIPLINUAR, PËR TË VLERËSUAR DHE PËRMIRËSUAR EFEKTSHMËRINË E PROCESEVE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT, KONTROLLIT DHE QEVERISJES.</li> <li>• <b>LLOGARIDHËNIA MENAXHERIALE</b> - NËNKUPTON PËRGJEGJËSINË E MENAXHERËVE PËR VEPRIMET, VENDIMET, REZULTATET DHE POLITIKAT, DUKE PËRFSHIRË ADMINISTRIMIN, QEVERISJEN DHE ZBATIMIN BRENDIA FUSHËVEPRIMIT TË POZITËS, DHE DETYRIMIN PËR TË RAPORTUAR, SHPJEGUAR DHE PËRGJIGJUR NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, STANDARDET, KOHËN DHE BUXHETIN, NDAJ ORGANIT I CILI I KA EMËRUAR ATA OSE TË CILËVE U KA DELEGUAR PËRGJEGJËSINË;</li> <li>• <b>SIGURI E ARSYESHME</b> - NËNKUPTON NIVELIN E KËNAQSHËM TË BESIMIT, QË KOSTOJA E KONTROLLIT NUK I TEJKALON PËRFITIMET E PRITURA;</li> <li>• <b>MENAXHIMI I RREZIKUT</b> ËSHTË PROCES I PËRGJITHSHËM I IDENTIFIKIMIT, VLERËSIMIT DHE MONITORIMIT TË RREZIQEVE DHE ZBATIMIT TË KONTROLLEVE TË NEVOJSHME PËR TË MBAJTUR EKSPLOZIMIN NDAJ RREZIKUT NË NJË NIVEL TË PRANUESHËM. KJO DUHET TË INTEGROHET SI PJESË E PROCESIT TË PËRGJITHSHËM TË MENAXHIMIT.</li> <li>• <b>RREZIKU</b> - REFLEKTON PASIGURINË DREJT ARRITJES SË OBJEKTIVAVE TË SUBJEKTIT. EKSPLOZIMI NDAJ RREZIKUT ËSHTË KOMBINIMI I PROBABILITETIT</li> </ul> |

|  |   |
|--|---|
|  | <p>(GJASËS QË DO TË NDODHË NJË NGJARJE) DHE NDIKIMIT TË NGJARJES NËSE KJO NDODHË.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>APETITI NDAJ RREZIKUT</b> – NIVELI I RREZIKUT TË CILIN SUBJEKTI ËSHTË I GATSHËM TA PRANOJ NË MËNYRË QË TË ARRIJ OBJEKTIVAT E VETA.</li> <li>• <b>NDIKIMI</b> – NËNKUPTON EFEKTIN E NJË NGJARJE JO TË FAVORSHME QË DO TË KETË PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE, NËSE NGJARJA NDODHË.</li> <li>• <b>INCIDENT</b> – NJË NGJARJE RREZIKU QË KA NDODH.</li> <li>• <b>RREZIKU I QENËSISHËM (INHERET)</b> – NIVELI I RREZIKUT NË MUNGESË TË KONTROLLEVE.</li> <li>• <b>RREZIKU I MBETUR (RESIDUAL)</b> – NIVELI I RREZIKUT PAS IMPLEMENTIMIT TË KONTROLLEVE.</li> <li>• <b>PRONAR I RREZIKUT</b> - PERSONI PËRGJEGJËS PËR MENAXHIMIN E NJË RREZIKU TË CAKTUAR TË LIDHUR ME OBJEKTIVIN(ET) QË AI/AJO ËSHTË PËRGJEGJËS.</li> </ul> |
|--|---|

## PROCEDURA

| Nr. | HAPI                                   | NËN-HAPAT  |
|-----|--|--|
| I   | Përgjegjësitë e menaxhimit të rrezikut | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ministri është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të dokumentuar në kuadër të Ministrisë, i cili përfshin: identifikimin e ngjarjeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave; vlerësimin e rrezikut lidhur me mundësinë e ndodhjes dhe ndikimin; si dhe veprimet ndaj rrezikut me qëllim të shmangies, transferimit, pranimit, ndarjes apo zvogëlimit të rrezikut;</li> <li>2. Ministri mund të delegojë përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut te menaxherët, të cilët janë: ZKA, drejtuesit e lartë, mbajtësit e buxhetit dhe menaxherët e tjerë;</li> <li>3. Ministri cakton:               <ol style="list-style-type: none"> <li>a. menaxherin e rrezikut;</li> <li>b. anëtarët e komitetit të rrezikut, kompetent dhe me njohuritë e nevojshme;</li> <li>c. aprovon politikën e menaxhimit të rrezikut;</li> <li>d. aprovon PSO-në për menaxhim të rrezikut;</li> <li>e. merr veprime për zbatim të rekomandimeve të Auditimit të brendshëm, Auditimit të jashtëm dhe Komitetit të rrezikut për të përmirësuar proceset e menaxhimit të rrezikut në ministri;</li> <li>f. ofron siguri tek palët e interesit se rreziqet janë duke u identifikuar, vlerësuar dhe zvogëluar tremujore;</li> </ol> </li> <li>4. Llogaridhënia për menaxhimin e rrezikut mbetet nën përgjegjësin e Ministrit.</li> </ol> |
| II  | Përgjegjësia e menaxherit ekzekutiv    | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Menaxheri ekzekutiv si pronar i rrezikut është përgjegjës dhe llogaridhënës për zvogëlim të ekspozimit të rrezikut për funksionin dhe proceset që i menaxhon, si dhe për zhvillimin e planeve për përgjigje ndaj rrezikut;</li> <li>2. Zyrtarët që ushtrojnë funksione menaxheriale, dhe të cilët kanë llogaridhënie menaxheriale, janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te zyrtari kryesor administrativ (ZKA) i Ministrisë për procesin e buxhetit, statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, rreziqet që parandalojnë përmbushjen e objektivave dhe masat e ndërmarra për minimizimin e tyre në institucionin që drejtojnë;</li> <li>3. Zyrtari kryesor financiar ZKF i përgjigjet ZKA-së, si dhe kryen përgjegjësitë sipas legjislacionit në fuqi;</li> <li>4. Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha nivelet, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e</li> </ol>   |

|     |                                       |  |
|-----|---------------------------------------|--|
|     |                                       | <p>Ministrisë, në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe transparencës, si dhe i raporton Ministrit;</p> <p>5. Menaxherët e strukturave të brendshme dhe mbajtësit e buxhetit të Ministrisë, janë përgjegjës ndaj mbikëqyrësve të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë për menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve dhe buxhetit për të cilat u janë deleguar përgjegjësitë;</p> <p>6. Përgjegjësi institucional sipas pikës 1,2,3,4 dhe 5 të këtij hapi, është përgjegjës të:</p> <p>a. raportoi në baza tremujore dhe sipas nevojës për rreziqet e reja të identifikuar përmes Regjistrit të rrezikut;</p>                     |
|     |                                       | <p>b. raportoi incidentet te Menaxheri i rrezikut në momentin kur ndodhin;</p> <p>c. identifikoi veprime/kontrolle/rekomandime për menaxhim të rreziqeve, me afate kohore të vendosura për implementim dhe të caktohen përgjegjësitë për implementim;</p> <p>d. monitoroi dhe raportojnë implementimin e veprimeve/kontrolleve/rekomandimeve;</p> <p>e. kërkoj përgjegjësi rreth menaxhimit të rrezikut nga zyrtarët që i kanë nën menaxhim;</p> <p>f. siguroi për funksionimin e duhur të kontrolleve të brendshme brenda fushës së përgjegjësisë.</p>  |
| III | Përgjegjësia e menaxherit të rrezikut | <p>1. Rishikon dhe përditëson kornizën për menaxhim të rrezikut në Ministri dhe e dorëzon për aprovim;</p> <p>2. Rekomandon apetitin e rrezikut për aprovim;</p> <p>3. Koordinon dhe asiston në vlerësimin e rrezikut dhe konsolidon format e identifikimit të rreziqeve të identifikuar nga pronarët e rrezikut;</p> <p>4. Përgatit raporte në baza tremujore dhe sipas kërkesës për menaxhim të rrezikut të cilat i adreson tek Udhëheqësi i Ministrisë dhe Komiteti i Auditimit;</p> <p>5. Ofron udhëzime për njësitë organizative në identifikim, vlerësim dhe trajtim të rrezikut;</p> <p>6. Koordinon implementimin e planeve të veprimit.</p> |
| IV  | Përgjegjësia e të punësuarve në MSh   | <p>1. Të gjithë të punësuarit kanë përgjegjësi për kontrollin e brendshëm si pjesë e përgjegjësisë së tyre për përmbushjen e objektivave;</p> <p>2. Të punësuarit duhet të kenë njohuri, aftësi, informata dhe autoritet për të krijuar, vënë në funksionim dhe monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm.</p>   |

|      |                                       |   |
|------|---------------------------------------|---|
| V    | Përgjegjësia e Komitetit të Auditimit | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përmes Statutit të Komitetit të Auditimit definohet në mënyrë formale përgjegjësia e KA-së rreth menaxhimit të rrezikut</li> <li>2. Gjatë takimeve të rregullta periodike, pjesë e agjendës duhet të jetë Menaxhimi i Rrezikut (takimeve tremujore);</li> <li>3. Rishikon dhe komenton Raportin Vjetor të Rrezikut në baza vjetore;</li> <li>4. Rishikon dhe vlerëson aktivitetet e Auditimit të Brendshëm që lidhen me auditimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut (vjetore);</li> <li>5. Rishikon planin vjetor të Auditimit të Brendshëm për t'u siguruar se a janë përfshirë fushat me rrezik të lartë për auditim në baza vjetore;</li> <li>6. Rishikon Regjistrin e Rrezikut në baza tremujore</li> </ol> |
| VI   | Përgjegjësia e auditimit të brendshëm | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ofron siguri të arsyeshme rreth hartimit të proceseve për menaxhim të rrezikut dhe efektivitetit të tyre;</li> <li>2. Ofron siguri të arsyeshme rreth “rreziqeve kryesore” të identifikuar dhe vlerësuara përfshirë edhe efektivitetin e kontrolleve për zvogëlim;</li> <li>3. Ofron siguri të arsyeshme rreth vlerësimit dhe raportimit të rrezikut;</li> <li>4. Shfrytëzon të dhënat nga Regjistri i Rrezikut për planifikim vjetor të auditimeve të bazuara në rrezik.</li> </ol>  |
| VII  | Identifikimi i rrezikut               | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ky është një veprim sistematik që ka për qëllim të identifikojë dhe dokumentojë rreziqet kryesore të cilave i ekspozohet Ministria;</li> <li>2. Menaxhmenti duhet të identifikojë rreziqet për secilin objektiv;</li> <li>3. Ky proces përfshin përcaktimin e rreziqeve që mund të pengojnë Ministrinë në arritjen e secilës objektivë të saj;</li> <li>4. Qasja ideale është një kombinim i rishikimit të rrezikut lartë-poshtë dhe vetëvlerësimit poshtë-lartë, ku secila pjesë e Ministrisë kontribuon me perceptimin e rreziqeve që përballet në arritjen e objektivave kyçe.</li> </ol>  |
| VIII | Plotësimi i hartës së proceseve       | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kreu i cili përmban informacione mbi emrin e Ministrisë;</li> <li>2. Kodi i procesit, nënkupton një shënim numerik ose me shkronja të një procesi që Ministria mund t'i caktoj proceset individuale si p.sh. MSHP-1 (Menaxhimi i Shpenzimeve Publike - procesi 1 në libër);</li> <li>3. Titulli i procesit, i caktuar në momentin e përfshirjes në Formatin e Identifikimit të Procesit. (titulli duhet të tregojë shkurtimisht dhe në mënyrë të përmbledhur se për cilin proces bëhet fjalë si p.sh. MSHP);</li> <li>4. Objektiva e procesit në katër dimensione (strategjik, operacional, pajtueshmëria, raportimi);</li> </ol>   |

|    |  |  |
|----|--|--|
|    |  | <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Numërimin e nënproceseve ose fazave të identifikuara brenda një procesi;</li> <li>6. Pronarin e procesit – çdo proces duhet të ketë pronarin apo drejtuesin e tij, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit;</li> <li>7. Përshkrimin e shkurtër të procesit që përmban informacion për inputet, nënproceset ose aktivitetet, sistemet që përfshihen dhe produktet / dokumentet që gjenerohen në përfundim të procesit;</li> <li>8. Lidhjet me proceset/nënproceset/procedurat e tjera. Nëse një proces lidhet diku gjatë zhvillimit me procese të tjera që zbatohen në Ministri, ose midis subjekteve ose me nën-procese apo procedura të tjera, është e nevojshme të cilësohet lidhja midis tyre;</li> </ol> |
|    |  | <ol style="list-style-type: none"> <li>9. Nëse nuk ka lidhje me procese apo procedura të tjera, atëherë ky nënhap nuk plotësohet;</li> <li>10. Struktura apo subjekte të tjera të përfshira në proces dhe burimet e nevojshme. Lidhur me burimet, duhet të identifikohen dhe të shkruhen burimet e përdorura apo që duhen për përmbushjen e aktiviteteve përbërëse të procesit. Kjo mund të përfshijë punonjësit që zbatojnë procesin, pajisjet që përdoren gjatë punës, etj.;</li> <li>11. Korniza ligjore – lista e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve relevante apo që lidhen me proceset;</li> <li>12. Afatet- nëse ekzistojnë.</li> </ol>  |
| IX | Teknikat për identifikim të rrezikut     | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Intervista dhe diskutime me grupe të interesit;</li> <li>2. Qasje në gjetjet dhe rekomandimet e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm;</li> <li>3. Qasje në incidentet në të kaluarën dhe në mësimin e nxjerrë nga to;</li> <li>4. Analizë të skenarëve; dhe</li> <li>5. Diagramet e rrjedhjes së proceseve, etj.</li> </ol>   |
| X  | Dokumentimi i rreziqeve të identifikuara | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përshkrimin e rrezikut dhe identifikimi për secilin rrezik;</li> <li>2. Data e regjistrimit të rrezikut;</li> <li>3. Njësia organizative dhe procesi i punës;</li> <li>4. Kategoria e rrezikut;</li> <li>5. Objektiva/prioriteti i Ministrisë; dhe</li> <li>6. Shkaku dhe ndikimi i mundshëm.</li> </ol>   |
| XI | Analiza e rrezikut                       | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rreziku vlerësohet sipas kombinimit të probabilitetit dhe ndikimit të tij, duke shfrytëzuar matricën për vlerësimin e rrezikut;</li> <li>2. Rreziqet analizohen duke marr në konsideratë mundësinë e ndodhjes dhe ndikimi, si bazë për të vendosur se si e ato rreziqe duhet të menaxhohen;</li> <li>3. Rreziqet vlerësohen në baza të qenësishme dhe të mbetura;</li> </ol>   |

|      |  |  |
|------|--|--|
|      |  | <p>4. Ministria definon shkallët e rrezikut në terma të ndikimit, gjasës dhe dimensioneve tjera. Këto shkallë përbëjnë nivelin rangues dhe definicionet të cilat mundësojnë interpretim dhe aplikim nëpër fusha të ndryshme;</p> <p>5. Shkallët duhet të lejojnë diferencim të kuptueshëm për qëllime rangimi dhe prioritizimi;</p> <p>6. Qasja e përgjithshme është të përgatitet një matricë, që do të vlerësojë secilin rrezik sipas:</p> <p>a. probabilitetit ose gjasës së ndodhjes së tij dhe</p> <p>b. ndikimit ose seriozitetit nëse ndodh.</p> <p>7. Matrica gjasë (x) ndikim mund të jenë 3, 5 dhe 10 shkallë, dhe përzgjedhja varet nga industria, madhësia dhe kultura e subjektit. Për Ministrinë është zgjedh matrica 5 shkallë.</p> |
| XII  | Vlerësimi i Rrezikut                     | <p>1. Në mënyrë që analiza e rrezikut të jetë më efektive, Ministria mund të përdor kombinim të tri teknikave për analizë të rrezikut si: vlerësimin sasior (kuantitativ), gjysmë sasior (gjysmë kuantitativ) dhe cilësor (kualitativ).</p> <p>2. Vlerësimi iniciues i rreziqeve kryhet duke përdorur teknika kualitative të përcjella me trajtim kuantitativ ndaj rreziqeve më kryesore të cilave u ekspozohet institucioni;</p> <p>3. Vlerësimi i rrezikut të kryhet në tri faza:</p> <p>a. vlerësimi i rrezikut të qenësishëm (inherent),</p> <p>b. vlerësimi i rrezikut të mbetur (residual),</p> <p>c. rreziku i mbetur të vlerësohet se është brenda apetit të rrezikut të përcaktuar</p>  |
| XIII | Kategorizimi i Rrezikut                  | <p>1. Rreziku duhet të vlerësohet bazuar në mundësinë e ndodhjes dhe ndikimit që ajo ngjarje mundet me pas në objektivat e Ministrisë;</p> <p>2. Ministri siguron që objektivat e Ministrisë të jenë të vendosura në planet strategjike dhe vjetore, dhe të dokumentuara sipas kategorive, si në vijim:</p> <p>a. strategjike - bazuar në planet strategjike të Ministrisë;</p> <p>b. operative - bazuar në planet e veprimit të Ministrisë;</p> <p>c. financiare - bazuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve, në ligjin vjetor të buxhetit si dhe aktet nënligjore të aplikueshme financiare; dhe</p> <p>d. pajtueshmërisë - bazuar në kornizën e aplikueshme ligjore.</p>  |
| XIV  | Identifikimi dhe vlerësimi i kontrolleve | <p>1. Për secilin rrezik të identifikuar, mund të dizajnohet një kontroll apo një grup kontrollesh për të adresuar rrezikun;</p> <p>2. Ministri është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave të cilat sigurojnë që rreziqet menaxhohen ashtu siç parashihen në planin për menaxhimin e rrezikut, dhe së paku përfshinë:</p> <p>a. procedurat për autorizim dhe aprovim;</p>  |



|    |   |  |
|----|---|--|
|    |   | <ul style="list-style-type: none"> <li>b. ndarjen e detyrave për aprovim, realizim, buxhetim dhe kontroll;</li> <li>c. rregullat për qasje në pasuri dhe informata;</li> <li>d. rishikimin e pajtueshmërisë para ndodhjes;</li> <li>e. procedurat për plotësi, besueshmëri, saktësi dhe në kohën e duhur për operacionet e financimit;</li> <li>f. kontrollet pas faktit të ndodhjes;</li> <li>g. rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore; dhe</li> <li>h. rregullat për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe aktiviteteve të Ministrisë</li> </ul>   |
| XV | Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontrollet drejtuese zhvillohen me qëllim që të sigurojnë arritjen e një rezultati të veçantë si: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. përkufizimin e politikave;</li> <li>b. vendosjen e synimeve;</li> <li>c. trajnimin dhe punësimin; dhe</li> <li>d. masat e sigurisë.</li> </ul> </li> <li>2. Kontrollet parandaluese janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. ndarja e detyrave;</li> <li>b. autorizimi dhe miratimi;</li> <li>c. kontrolli i qasjes në pasuri; dhe</li> <li>d. verifikimi i saktësisë aritmetike parapagesës;</li> </ul> </li> <li>3. Kontrollet detektive përdoren për të përmirësuar procedurat ose kontrollet preventive. Kontrollet detektive, përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. harmonizimin;</li> <li>b. verifikimin;</li> <li>c. rishikimin e proceseve dhe aktiviteteve; dhe</li> <li>d. rishikimin e performancës operative.</li> </ul> </li> <li>4. Kontrollet preventive dhe detektive zhvillohen për: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. sigurimin e pasurive dhe të dhënave fizike dhe intelektuale;</li> <li>b. mbrojtje fizike;</li> <li>c. mirëmbajtje të të dhënave të vazhdueshme;</li> <li>d. llogaritje periodike/inventarët fizik;</li> <li>e. krahasimin e llogaritjeve/ inventarëve me të dhëna;</li> <li>f. procedurat e identifikimit dhe analizimin e dallimeve, dhe veprimet adekuate që janë ndërmarr për korrigjimin ose eliminimin e tyre;</li> <li>g. kontrollet e qasjes si fjalëkalimet, letërnjoftimet, rojet, kyçje në kompjuter; dhe</li> <li>h. ndarjen e detyrave me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit</li> </ul> </li> <li>5. Kontrollet korrigjuese zhvillohen për korrigjimin e rezultateve të padëshiruara pasi që të jenë zbuluar. Çfarëdo veprimi që</li> </ol> |

|     |                     |  |
|-----|---------------------|--|
|     |                     | <p>korrigjon gabimet ose lëniet anash merret në konsideratë si kontroll korrigjues.</p> <p>6. Për secilin rrezik të identifikuar:</p> <p>a. përshkruhet kontrollet e dizajnuar: cili është një proces, politikë, pajisje, praktikë apo tjetër veprim i cili përdoret për të modifikuar gjasën ose pasojën e ngjarjes së rrezikut që ndodh? nëse nuk ka kontroll, atëherë ka dobësi në sistem të kontrollit.</p> <p>b. vlerësimi i efektivitetit të kontrollit – cili është efektiviteti i përgjithshëm i kontrollit në terma të dizajnit të tij dhe operimit?</p> <p>c. identifikimi i pronarit të kontrollit – kush është pronari i kontrollit? a është person ose rol me përgjegjësi për tu siguruar se aktiviteti i kontrollit është në vend dhe operon në mënyrë efektive. pronari i kontrollit jo domosdoshmërisht kryen aktivitetin e kontrollit, por duhet me pas mbikëqyrje të performacës së kontrollit.</p> <p>d. testimi i kontrollit – kur ka qenë për herë të fundit ajo kontroll e testuar?</p> <p>e. rishikimi i kontrollit – kur duhet që kontrolli të testohet dhe të rishikohet?</p> |
| XVI | Trajtimi i rrezikut | <p>1. Menaxhmenti zhvillon strategji për t'iu përgjigjur të gjitha rreziqeve materiale, me prioritet rreziqet që i afrohen apo tejkalojnë apetitin e rrezikut;</p> <p>2. Strategjitë për përgjigje ndaj rrezikut dokumentohen së bashku me përgjegjësitë dhe afatet për zbatim;</p> <p>3. Përgjigjet ndaj rrezikut zhvillohen në mënyrë që Ministria të sigurohet se strategji të duhura/plane veprimi janë zhvilluar së paku për rreziqet e vlerësuara si të “larta” dhe “ekstreme”, në mënyrë që të reduktohet ndikimi dhe gjasa e një ngjarje rreziku potenciale për të ndodhur;</p> <p>4. Strategjitë për menaxhim të rrezikut duhet të jenë SMART<sup>1</sup>, që do të thotë se kur të përpilohen planet e veprimit të merren parasysh kriteret si:</p> <p>a. specifike– çka duhet të arrihet? pse? nga kush? ku? cilat kërkesa dhe kufizime janë të aplikueshme?;</p> <p>b. të matshme – sa? si e dimë kur është arritur qëllimi? indikatorët duhet të jenë të matshëm;</p> <p>c. të arritshme – reale dhe të arritshme me burimet (humane dhe financiare) në dispozicion;</p>                  |

<sup>1</sup> George T. Doran, There's a S.M.A.R.T. way to write management's goals and objectives

|      |  |   |
|------|--|---|
|      |  | <p>d. relevante– ndihmon ministrinë për progres; duhet që të bëhet përpjekje; në kohën e duhur; të jetë i aplikueshëm për natyrën në të cilën subjekti operon;</p> <p>e. periudha kohore – kur? (vendosja e afateve kohore; respektimi i afateve kohore).</p>   |
| XVII | Zgjidhja e opsioneve të ndryshme të kontrolleve për zbutje të rrezikut | <p>1. Pasi është përgatitur profili i rrezikut, sipas hapave të mësipërm, Ministri reagon ndaj secilit rrezik, duke ndërmarrë veprime për lehtësimin e rrezikut.</p> <p>2. Ekzistojnë 4 kategori<sup>2</sup> të veprimeve për lehtësimin e rrezikut, prej të cilave Ministri përzgjedh përgjigjen më efektive:</p> <p>a. trajtimi deri në kufizim ose reduktim të rrezikut - ZKA i Ministrisë, ka përgjegjësi të qartë për të zbatuar kontrollet e brendshme për menaxhimin e rreziqeve;</p> <p>b. ndërprerja e rrezikut - ndërprerja e rrezikut realizohet me reduktimin ose kufizimin e disa aktiviteteve;</p> <p>c. transferimi i rrezikut - rreziku mund të transferohet te pala e tretë, me anë të blerjes së sigurimit ose mjeteve të tjera kontraktuale, që përcaktojnë se pala e tretë do të mbulojë çfarëdo pasoje të pafavorshme të materializimit të rrezikut;</p> <p>d. tolerimi i rrezikut - mund të mos jetë e mundshme që të gjinden mjete me kosto efektive për të lehtësuar rreziqet e caktuara, në veçanti rreziqet me shkallë të ulët që nuk kanë ndikim të madh në kapacitetin operativ. Në këtë rast, Ministri mund të zgjedhë që të pranojë rrezikun, ndoshta të lërë anash disa rezerva financiare për të mbuluar çfarëdo humbje. Nëse rreziku tolerohet, kjo duhet të jetë rezultat i vendimit me qëllim nga Ministri dhe nuk është rezultat i neglizhimit të vlerësimit dhe të vendoset për të reaguar ndaj rreziqeve;</p> <p>3. Për të siguruar trajtim efektiv të rrezikut janë disa çështje që menaxheri i rrezikut duhet t'i merr parasysh si:</p> <p>a. pyet rreth trajtimeve të mundshme dhe të simuloj diskutimin;</p> <p>b. tërheq vëmendjen tek rreziqet e kategorizuara si të larta apo ekstreme dhe të diskutoj me pjesëmarrësit rreth mënyrës për trajtim;</p> <p>c. prezantoj opsionet për trajtim të rrezikut;</p> <p>d. në rast nevojë të ftohen ekspert të fushave specifike për trajtim;</p> <p>e. të dokumentohen diskutimet dhe të vihen në vëmendje të menaxhmentit për përmirësim dhe menaxhim të rrezikut;</p> <p>f. nëse iniciativa për menaxhim të rrezikut kërkon zhvillimin apo avancimin e proceseve ekzistuese atëherë zgjedhjet për</p> |

<sup>2</sup> Doracaku për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

|       |                                     |  |
|-------|-------------------------------------|--|
|       |                                     | <p>trajtim duhet të vendosen si një projekt i ri apo të vendoset në planin strategjik të ministrisë;</p> <p>g. për realizimin e zgjedhjes për trajtim kërkohet që të vendoset se kush është përgjegjës për zhvillim të strategjisë së trajtimit, të specifikohet se cili do të jetë rezultati i pritshëm, të vendosen afatet kohore dhe të vendoset lista e resurseve të nevojshme ndihmon realizimin.</p>   |
| XVIII | Analiza kost benefit                | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Analiza kosto/benefit peshon kostot totale të pritshme të opsioneve në terma monetarë kundrejt përfitimeve totale të pritshme për të zgjedhur opsionin më efektiv ose më fitimprurës;</li> <li>2. Mund të jetë sasiore ose cilësore, ose të përfshijnë një kombinim të elementeve sasiore dhe cilësore, që mund të aplikohen në çdo nivel të Ministrisë;</li> <li>3. Palët e interesuara që marrin përfitime të prekshme apo të paprekshme, duhet të identifikojnë koston direkte<sup>3</sup> dhe indirekte<sup>4</sup>;</li> <li>4. Në analizën kosto/benefit, vlera monetare i përcaktohet të gjitha përfitimeve dhe shpenzimeve të prekshme dhe të paprekshme (shtojca 1).</li> </ol>   |
| XIX   | Raportimi dhe monitorimi i rrezikut | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Profili i rrezikut të organizatës iu komunikohet në kohën e duhur të gjithë palëve relevante të interesit, në lidhje me objektivat e saj strategjike, operationale dhe me apetitin ndaj rrezikut;</li> <li>2. Raportet periodike të rrezikut përgatiten nga Menaxheri i rrezikut dhe duhet të përmbajnë elemente si: <ol style="list-style-type: none"> <li>a. dashboard të cilat prezantojnë rreziqet kryesore dhe gjendjen aktuale të menaxhimit të rrezikut brenda njësive të ndryshme organizative;</li> <li>b. raporti i rreziqeve të reja në rritje.</li> </ol> </li> <li>3. Rreziqet aktive pas një periudhe mund të mos jenë më relevante për Ministrinë dhe si të tilla duhet të iu ndërrohet statusi, jo të fshihen nga Regjistri!;</li> <li>4. Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi i regjistrit të rrezikut dhe planeve me strategji për trajtim duhet të vlerësohen në mënyrë të rregullt.</li> <li>5. Statusi i planit të veprimit mund të jetë: <ol style="list-style-type: none"> <li>a. nuk ka filluar: 0%;</li> <li>b. implementimi në proces: 1%-99%</li> </ol> </li> </ol> |

<sup>3</sup> Kostot direkt janë ato që lidhen drejtpërdrejt me veprimin

<sup>4</sup> Kostot indirekte janë kosto oportune shtesë, të tilla si humbja e vlerës, shpenzim i kohës për menaxhim ose devijime në investime.

|     |   |   |
|-----|---|---|
|     |   | <p>c. i implementuar: 100%</p> <p>6. Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i procesit të menaxhimit të rrezikut dhe rezultatet duhet të jenë pjesë e planifikimit të menaxhimit të rrezikut me përgjegjësi qartë të definuara.</p>  |
| XX  | Regjistri i rrezikut                              | <p>1. Regjistri i rrezikut është instrumenti përmes të cilit identifikohen rreziqet, regjistrohen, vlerësohen, zgjedhën strategjitë për trajtim të rreziqeve;</p> <p>2. Përmes rishikimit të rregullt gjurmohet zbatimi i këtyre strategjive dhe ndikimin i zbatimit apo mos zbatimit të tyre;</p> <p>3. Regjistri i rrezikut përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Objektivat,</li> <li>b. Përshkrimi i rrezikut,</li> <li>c. Nxitësit/shkaqet,</li> <li>d. Përshkrimi i ndikimit të mundshëm/pasojave,</li> <li>e. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit</li> <li>f. Niveli i qenësishme/inherent i rrezikut,</li> <li>g. Kontrollat ekzistuese,</li> <li>h. Niveli i mbetur/residual i rrezikut,</li> <li>i. Kontrollat e nevojshme shtesë (nëse ka ndonjë),</li> <li>j. Përgjegjësia për zhvillimin dhe zbatimin e kontrollit (eve) të reja, (Modeli i dhënë në shtojcën 2)</li> <li>k. Plani kohor (bazuar në prioritetet e përcaktuara nga shkalla</li> </ol> <p>4. Regjistri i rishikuar i rrezikut, duhet të nxirret pas secilit rishikim dhe të azhurnohet sipas nevojës.</p> |
| XXI | Indikatorët kyç të rrezikut dhe monitorimi i tyre | <p>1. Indikatorët kyç të rrezikut, matës të cilët janë të lidhur me rrezik specifik, ofrojnë indikacion se kontrollat e zbatuara funksionojnë ashtu siç kërkohet;</p> <p>2. Indikatorët mund të jenë parashikues të ngjarjeve të rëndësishme ose rreziqeve të cilat mund të kenë ndikim negativ në Ministri;</p> <p>3. Indikatorët kyç të rrezikut për proceset e Ministrisë ndihmojnë në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve potenciale të cilat ndikojnë operacionet, financat dhe efektivitetin e përgjithshëm;</p> <p>4. Ministria zhvillon IKR duke plotësuar kriteret si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Të jenë relevant për procesin apo rrezikun që monitorohet;</li> <li>b. Të jenë të matshëm duke u shprehur në formë numerike dhe duke krijuar pragje;</li> <li>c. Të kenë veçori paralajmëruese në mënyrë që të mundësohet parandalimi i ngjarjeve të mundshme të rrezikut;</li> <li>d. Të dizajnohen në mënyrë që të jenë lehtë të monitorueshëm, të arrijë një nivel të automatizimit pa i humbur veçoritë tjera të rëndësishme;</li> </ol>                           |

|      |                                      |   |
|------|--------------------------------------|---|
|      |                                      | <p>e. Të jetë i mundur krahasimi i indikatorëve në periudha të ndryshme kohore, dhe mes pragjeve të paracaktuara të rrezikut;</p> <p>f. Të jenë të auditueshëm në mënyrë që të lehtësohet proces i verifikimit të tyre.</p> <p>5. Për monitorimin e IKR-vë merren parasysh elementet si raportimi i IKR-ve sipas frekuenca e azhurnimit të tyre dhe më pas krahasimit sipas periudhave kohore, monitorimi për tejkalimin eventual të pragjeve të paracaktuara dhe trendi i lëvizjes së IKR-ve;</p> <p>6. Njësit organizative janë përgjegjëse që raportimin e IKR-ve ta bëjnë tek Menaxheri i Rrezikut;</p> <p>7. Raportimi i IKR-ve bëhet në baza të rregullta tremujore, gjashtëmujore apo vjetore, varësisht nga frekuenca e azhurnimit të indikatorëve.</p>   |
| XXII | Raportimi dhe trajtimi i incidenteve | <p>1. Procedurat e raportimit të incidenteve brenda Ministrisë duhet ndjekin një proces të strukturuar për të siguruar që incidentet e mundshme të adresohen në mënyrë efikase dhe efektive</p> <p>2. Zyrtarët e përfshirë në incident duhet që incidentin ta raportojnë në momentin e identifikimit të incidentit.</p> <p>3. Raportimi duhet që të bëhet tek mbikëqyrësi direkt ose zyrtari përgjegjës për njësinë organizative ose procesin ku ka ndodh incidenti dhe funksioni i menaxhimit të rrezikut;</p> <p>4. Raportimi duhet të bëhet përmes e-mail apo ndonjë aplikacioni të dizajnuar për këtë qëllim. (Në shtojcën 3 është dhënë formulari për plotësim me të detajet rreth incidentit);</p> <p>5. Detaje specifike rreth incidentit të cilat duhet të ofrohen gjatë raportimit të një incidenti janë:</p> <p>a. Të përshkruhet incidenti;</p> <p>b. Vendi;</p> <p>c. Data dhe koha;</p> <p>d. Emri i personit që raporton. (Të dhënat e kontaktit të raportuesit mblidhen në rast se nevojiten informacione shtesë ose për të dhënë përditësime mbi statusin e incidentit).</p> <p>6. Përmes kësaj forme bëhet informimi rreth incidentit të ndodhur dhe fillohet me trajtimin e incidentit;</p> <p>7. Incidenti duhet të trajtohet nga mbikëqyrësi (ose i deleguari nga ai), në konsultim me zyrtarin e përfshirë, menaxherin e rrezikut dhe me personelin tjetër relevant ose ekspertin e fushës kur është e nevojshme;</p> <p>8. Në mënyrë që të identifikohet burimi i incidentit, duhet që çdo e dhënë apo informacion rreth incidentit të mblidhet dhe analizohet;</p> |

|       |  |   |
|-------|--|---|
|       |  | <p>9. Funkzioni i menaxhimit të rrezikut shqyrton raportin e incidentit për të vlerësuar rrezikun e tij dhe për t'u përcaktuar prioriteti;</p> <p>10. Gjetjet dhe konstatimet e dala pas trajtimit të incidentit duhet të regjistrohen dhe fillohet me përgatitjen e një plani për veprim;</p> <p>11. Plani për veprim përmban rekomandime rreth përmirësimit apo shtimit të kontrolleve aty ku është identifikuar që kontrollet kanë munguar apo kanë dështuar;</p> <p>12. Incidentet me prioritet të lartë kërkojnë vëmendje të menjëhershme, ndërsa të tjerat ndjekin afatet kohore standarde të zgjidhjes;</p> <p>13. Incidenti i raportuar duhet të regjistrohet në një databazë apo sistem të centralizuar të menaxhimit të incidentit;</p> <p>14. Çdo incidenti i caktohet një identifikues unik për qëllime gjurmimi.</p> |
| XXIII | Marrja e sigurisë për menaxhimin e rrezikut    | <p>1. Njësia e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë, do të rishikojë procesin e Menaxhimit të Rrezikut dhe Regjistrin e Rrezikut, gjatë kohës së aktiviteteve të auditimeve që ka planifikuar dhe do të rekomandojë përmirësim të proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe shtim apo implementim të kontrolleve për menaxhimin e rreziqeve të identifikuara.</p>  |
| XXIV  | Trajnimi dhe vetëdijesimi i stafit në Ministri | <p>1. Ministria zhvillon dhe mirëmban programe për vetëdijesim rreth rrezikut për punëtorët dhe palët e interesit;</p> <p>2. Funkzioni i menaxhimit duhet të zhvilloj programin për vetëdijesim dhe t'i planifikoj të gjitha aktivitetet e rregullta;</p> <p>3. Ekzekutimi i këtij programi duhet të dokumentohet.</p>  |

## SHTOJCA I. LISTA E INDIKATORËVE KYÇ TË RREZIKUT

| Njësia organizative | Indikatori Kyç i Rrezikut   | Frekuenca e raportimit   | Vlera e indikatorëve për | Pragjet | I ULET | I MESEM | I LARTE |
|---------------------|---|--|--------------------------|---------|--------|---------|---------|
|                     | Varianca buxhetore<br><i>Raporti në mes të buxhetit të shpenzuar dhe atij të planifikuar</i>  | Monitorimi i mospërputhjeve ndërmjet shpenzimeve të buxhetuara dhe atyre aktuale mund të tregojë keq menaxhim financiar ose kosto të papritura                       |                          |         |        |         |         |
|                     | Shkalla e mbledhjes së të ardhurave<br><i>Shkalla e mbledhjes së të ardhurave (%) = (Të ardhurat totale të mbledhura / të ardhurat totale të detyrueshme) x 100</i> | Një normë në rënie e mbledhjes së të ardhurave mund të sugjerojë sfida ekonomike ose jo efikasitet në proceset e mbledhjes së taksave ose tarifave.                  |                          |         |        |         |         |
|                     | Nivelet e borxhit   | Rritja e nivelit të borxhit të subjektit mund të tregojë paqëndrueshmëri financiare dhe vështirësi të mundshme në përmbushjen e detyrimeve të borxhit.               |                          |         |        |         |         |
|                     | Numri i projekteve të pambaruara për mirëmbajtjen e infrastrukturës   | Një numër në rritje i projekteve të pambaruara sipas planit për mirëmbajtje dhe riparimit të infrastrukturës mund të sinjalizojë mungesë investimi në asete kritike. |                          |         |        |         |         |
|                     | Transparenca e Prokurimit   | Parregullsitë në proceset e prokurimit mund të ngrenë shqetësime rreth korrupsionit dhe keq menaxhimit.  |                          |         |        |         |         |
|                     | Performanca e Kontratës   | Monitorimi i performancës së kontratave me ofruesit e shërbimeve ndihmon në sigurimin e cilësisë dhe efektivitetit të kostos.  |                          |         |        |         |         |
|                     | Numri i shkeljeve të rregulloreve   | Shkeljet e shpeshta të rregulloreve ose mospërputhja me kërkesat ligjore mund të çojnë në rreziqe ligjore dhe financiare.  |                          |         |        |         |         |
|                     | Kërkesat ligjore dhe çështjet gjyqësore   | Një numër në rritje i kërkesave ligjore dhe padive kundër subjektit mund të rezultojë në barrë financiare.   |                          |         |        |         |         |
|                     | Incidentet e sigurisë kibernetike   | Rritje në numrin e shkeljeve të sigurisë kibernetike mund të ekspozojë të dhëna të ndjeshme dhe ndërprerje të operacioneve të subjektit.                             |                          |         |        |         |         |
|                     | Qarkullimi i punonjësve   | Shkalla e lartë e qarkullimit mund të çojë në joefikasitet, humbje të njohurive institucionale dhe rritje të kostove të trajnimit.                                   |                          |         |        |         |         |
|                     | Ndikimi në mjedis   | Dështimi për të përmbushur standardet mjedisore ose një rritje e incidenteve mjedisore mund të rezultojë në gjoba dhe dëmtim të reputacionit të subjektit.           |                          |         |        |         |         |
|                     | Treguesit e Shëndetit Publik  | Monitorimi i treguesve të shëndetit publik, veçanërisht gjatë krizave shëndetësore si pandemitë, është thelbësor për mbrojtjen e banorëve dhe menaxhimin e burimeve. |                          |         |        |         |         |
|                     | Koha e reagimit ndaj urgjencës  | Vonesat në kohën e reagimit ndaj emergjencave mund të rrezikojnë sigurinë publike dhe të rezultojnë në çështje të përgjegjësisë.                                     |                          |         |        |         |         |
|                     | Përgatitja për fatkeqësitë natyrore   | Vlerësimi i gatishmërisë së subjektit për fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet që lidhen me ndryshimet klimatike është jetik për vazhdimësi të punës.                   |                          |         |        |         |         |
|                     | Rritja e popullsisë   | Një popullsi në rënie mund të ndikojë në rrjedhat e të ardhurave, kërkesën për shërbime dhe vitalitetin e përgjithshëm ekonomik.                                     |                          |         |        |         |         |
|                     | Normat e larta të papunësisë  | Normat e larta të papunësisë mund të rëndojnë shërbimet sociale dhe të rrisin kërkesën për programe asistence.   |                          |         |        |         |         |
|                     | Treguesit e zhvillimit ekonomik   | Ndjekja e treguesve ekonomikë si rritja e vendeve të punës, zhvillimi i biznesit dhe investimet mund të vlerësojnë shëndetin ekonomik të subjektit.                  |                          |         |        |         |         |



## SHTOJCA 2. MODELI I REGJISTRIT TË RREZIKUT

| Risk Register   |  |   |                                |   |   |  |   |   |
|---|--|---|--------------------------------|---|---|--|---|---|
| IDENTIFIKIMI I RREZIKUT   |  |   |                                |   |   |  |   |   |
| ID e rrezikut   | Data e regjistrimit të rrezikut                | Njësia raportuese                           | Kategoria e rrezikut           | Objektivat/prioritetet e subjektit              | Procesi i punës                           | Ngjarja RREZIKU#   | Shkaku  | Pasoja/ndikimi  |
| Ti vendoset secilit rrezik një identifikues në mënyrë që të gjurmohet më lehtë? | Të vendoset data kur është regjistruar rreziku | Të zgjedhet njësia që ka raportuar rrezikun | Në cilën kategori të rrezikut? | Cilën objektiv të subjektit e ndikon ky rrezik? | Cilin proces të punës shoqëron ky rrezik? | Cilat ngjarje mund të ndikojnë në arrijten e objektivave ? | Cka e shkakton këtë ngjarje rreziku? (Shkas, rrethanë, pasiguri) e cila mund të rrit mundësinë që ngjarja e rrezikut të ndodh? Mund të jenë disa shkaktar të cilët mund të bëjnë që një ngjarje rreziku të ndodh. | Si ndikon kjo ngjarje rreziku në arrijte e objektivave/ apo mbarevajtjen e procesit të punës. |

| VLERESIMI I RREZIKUT                                   |   |  |  |  |  |  |  |  |
|--|---|--|--|--|--|--|--|--|
| Aaliza e rrezikut të qenësishëm/inherent               |   |  | Vlerësimi i kontrollës   |  |  | Analiza e rrezikut residual (të mbetur)          |  |  |
| Gjasa  | Ndikimi                                       | Rangimi i rrezikut inherent                      | Kontrollat ekzistuese  | Efektiviteti i kontroleve                            | Gjasa                                      | Ndikimi  | Rangimi i rrezikut residual                      |  |
| Të vlerësohet gjasa e ndodhjes së ngjarjes së rrezikut | Të vlerësohet ndikimi që ngjarja mund të ketë | Rangimi i rrezikut bazuar në gjasën dhe ndikimin | Clarë mekanizmi kontrolli është aktualisht në vend i dizajnuar që të menaxhoj ngjarje rreziku? Cilat kontrole reduktojnë mundësinë e ndodhjes? Cilat kontrole reduktojnë ndikimin nëse ndodh ngjarja e rrezikut? | Të vlerësohet efektiviteti i kontrollit të dizajnuar | Të vlerësohet gjasa që një rrezik të ndodh | Rangimi i rrezikut bazuar në gjasën dhe ndikimin | Rangimi i rrezikut bazuar në gjasën dhe ndikimin |  |

| TRAJTIMI I RREZIKUT                  |   |   |                          |
|--------------------------------------|---|---|--------------------------|
| Veprimi                              | Plani   | Pronar i rrezikut                                 | Data e fundit për zbatim |
| Të përshkruhet veprimi ndaj rrezikut | Të zgjedhet veprimi i planifikuar për trajtim të rrezikut | Të vendoset përgjegjësi për implementim të planit | Data e fundit për zbatim |

| MONITORIMI DHE RISHIKIMI I RREZIKUT  |                      |
|--|----------------------|
| Raportimi rreth progresit  | Statusi              |
| Gjurmoni dhe raportoni mbi progresin e planit(ëve) të veprimit dhe vini re çdo rast të mospërputhshmërisë, shkeljeve ose mungesës së afërt | Azhurnimi i statusit |

### SHTOJCA 3. FORMA E RAPORTIMIT TË INCIDENTIT

#### RAPORTI I INCIDENTIT

##### DETAJET E RAPORTUESIT

|                     |  |
|---------------------|--|
| Emri dhe mbiemri    |  |
| Pozita:             |  |
| Njësia organizative |  |
| Kontakti            |  |

##### PËRSHKRIMI I INCIDENTIT

|                     |                       |
|---------------------|-----------------------|
| LOKACIONI           |                       |
| Data:               | Detajet e incidentit: |
| Koha:               |                       |
| Palët e informuara: |                       |
|                     |                       |

| Shkaktaret e incidentit (Cause) | Pasoja nga incidenti | Rekomandimet për përmirësim të kontrolleve |
|---------------------------------|----------------------|--|
|                                 |                      |  |

|                              |  |
|------------------------------|--|
| Afatet për implementim:      |  |
| Përgjegjësi për implementim: |  |